
TË DREJTAT E FËMIJËS

MUNDËSIA DHE MBROJTJA E FËMIJËS PJESËMARRJA DHE DISPOZITAT MOSDISKRIMINIMI I FËMIJËVE INTERESI MË I MIRË I FËMIJËS

>> Në të gjitha veprimet kundrejt fëmijëve, qoftë të marra nga institucionet e mirëqenies publike apo nga ato private, gjyqet e drejtësisë, autoritetet administrative apo trupat legjislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë element primar...<<

NENI 3, KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS

TREGIM ILUSTRUES

Fëmijët e prekur nga konfliktet e armatosura

“Unë u rrëmbeva (nga Armata e Rezistencës së Zotit) kur unë dhe nëna ime ishim duke shkuar në fushë.... Njëra nga vajzat e rrëmbyera tentoi të ikte, por u kap. Rebelët na thanë se ajo tentoi të ikte, prandaj duhej vrrarë. Ata i shtynë fëmijët e rinj që ta vrasin atë. Ata na thanë se në qoftë se do të iknim, do të na i vrisnin familjet. Ata në detyruan të ecnim me javë të tëra Disa prej fëmijëve të vegjël nuk mund ta mbanin hapin kaq gjatë pa pushuar, dhe u vranë. . . . Disa prej fëmijëve vdiqën nga uria. Unë ndihesha pa jetë, duke parë aq shumë fëmijë duke u vdekur dhe duke u vrrarë. Unë mendova se do të vritem.”

BURIMI:

“MBRESAT E VDEKJES: FËMIJËT E RRËMBYER NGA ARMATA E REZISTENCËS SË ZOTIT NË UGANDË”, MBIKËQYRJA E TË DREJTAVE TË NJERIUT, SHTATOR 1999.

Sharona 13 vjeçare ishte rrëmbyer nga Armata e Rezistencës së Zotit, një grup rebelësh të vendosur në Ugandën veriore, të cilët luftojnë kundër qeverisë, por po ashtu terrorizojnë popullsinë lokale, duke grabitur dhe përdorur fëmijët në forcat e tyre rebeluese.

PYETJET PËR DISKUTIM?

Në më shumë se 85 vende përreth botës, fëmijët më të rinj se 18 vjeç rekrutohen në armata kombëtare apo grupe të armatosura kundërshtuese. 300.000 fëmijë marrin pjesë në mënyrë aktive në konflikte të armatosura. Cilat mund të jenë arsyet për përdorimin e fëmijëve për të luftuar në luftërat e të rriturve?

Përdorimi seksual i fëmijëve për përfitime

“Duke qëndruar në një kafene nate në hotelin e errët Del Roj, një natë, banakieri kalifornian, 33 vjeçari i quajtur Dejvid tha se ishte për herë të dytë në Kosta Rika në këto vitet e fundit. Ai fliste gjëra të pacipa se si i kishte hulumtuar disa web-faqe të internetit të cilat reklamonin prostituta vajza- fëmijë në Kosta Rika, në orvatjet e tij për të pasur marrëdhënie seksuale me vajza fëmijë të virgjëra. Dejvidi, një trupngjeshur i pakrehur, i cili insistonte të përdorej vetëm emri, mburrej se si e kishte rregulluar me njërin nga shoferët e shumtë të taksive të cilët ishin ndërlidhur me tregtinë seksuale, që t’ ia sjellë një vajzë 13 vjeçare nga shtëpia e prindërve të saj nga lagjia e varfër e San Hoses në hotelin e tij. Babai dhe nëna e vajzës kishin kërkuar 400\$ për shpërdorim të vajzës së tyre, të cilat Dejvidi i paguajti me etje.”

BURIMI:

“ SHPËRDORIMI SEKSUAL I VAJZAVE DHE DJEMVE NË NUMËR TË MADH NGA BURRAT AMERIKANË, KA ARRITUR PËRMASA ALARMUESE NË AMERIKËN QENDRORE,” UASHINGTON POST, 2 JANAR 2000.

PYETJET PËR DISKUTIM?

A mendoni se fëmijët kanë të drejtë të shpëtohen nga lëndimet?

Si mund të mbrohen ata nga këto forma të shpërdorimit?

A keni dëgjuar për ndonjë rast në shtetin tuaj në të cilin turistët janë gjykuar para gjyqeve nacionale për shpërdorim të fëmijëve në shtetet e tjera?

E DOMOSDOSHME TË DIHET!

1. BETEJA PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

Diskutimi për të drejtat e fëmijëve nganjëherë është një temë e çuditshme. Në të parë, të gjithë do të pajtoheshin mbi të drejtën për banim, për të jetuar me familje dhe shokë, për mundësi të zhvillimit të personalitetit dhe talentit, që të jetë i respektuar dhe të trajtohet seriozisht. Prapëseprapë, edhe pse të drejtat e fëmijëve duken mjaft të rregulluara, ka shumë probleme në zbatimin e tyre. Dikur, pyetjet e ngritur për përgjegjësinë e realizimit të këtyre pikësnyimeve, të formuluar si të drejtat e detyrueshme të fëmijëve, janë mbyllur. Shikoni një herë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Ky traktat ndërkombëtar, i miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në vitin 1989, përbën themelimin e mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të fëmijëve. Dhe, deri më tani është një sukses sepse KDF 14 vjet pas miratimit është ratifikuar nga 192 vende, duke përfshirë të gjithë anëtarët e KB-së, përveç dy shteteve (Somalisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës). Pra KDF rregullon me të vërtetë standardet universale të të drejtave të njeriut për fëmijët. Mirëpo, lajmi i mirë për anën e satandardeve, ashpër ballafaqohet me tablën shkatërrimtare në anën e zbatimit. Raporti i përbashkët i gjendjes në fund të dekadës nga KB/UNICEF-i për Sesionin Special të KB mbi Fëmijët, nxjerr në pah, për shembull, se shanset për mbijetesë të fëmijëve në Afrikën nën Saharë madje janë dëmtuar, deri sa globalisht, 149 milion fëmijë mbeten të ushqyer keq, dhe 100 milion fëmijë nuk ndjekin arsimimin fillor => faktet dhe figurat janë të poshtëshënuara. Pritjet ishin të mëdha si rrjedhim, kur 3355 delegatë qeveritarë, 1732 përfaqësues nga organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe më shumë se 600 të rinj (mosha prej 7 deri 18) u takuan në maj të vitit 2002 në New York gjatë Sesionit Special të Asamblesë së Përgjithshme mbi Fëmijët. Konferenca miratoi një plan të ri ndërkombëtar, Planin për Veprim (“Një botë e përshtatshme për fëmijët”) e cila bëri që qeveritë, UNICEF-it, organizatat e tjera ndërqeveritare dhe OJQ-të të zhvillojnë gati dy vjet bisedime, me një sukses të përzier. Dhe, çështja më problematike dhe padiskutim më e

vëshitira në këtë debat ishte pozita e Konventës për të Drejtat e Fëmijës në dokumentin përfundimtar, me disa shtete, si Shtetet e Bashkuara, të cilat e refuzonin si tërësi nga kjo konventë, deri te dokumenti përfundimtar i dalë për të drejtat e fëmijëve.

Të drejtat e fëmijës dhe siguria njerëzore/e fëmijëve

Koncepti mbi sigurinë njerëzore është përshkruar si një dokument i cili promovon lirinë e qenies njerëzore nga frika dhe kërkesa, me mundësi të barabarta për zhvillim të plotë të potencialit të tij njerëzor. Kështu, ai fokusohet në situatën e pasigurisë të shkaktuar nga dhuna dhe varfëria, të acaruar më tutje nga diskriminimi dhe përjashtimi shoqëror. Kërkesa për prioritet dhe elementi i emergjencës për t'iu kundërvënë kërcënimeve të drejtpërdrejta ndaj sigurisë së personit është qartë në të njëjtën vijë me atë të konceptit të së drejtave të fëmijës, në veçanti me parimin e konsiderimit si prioritet të interesit më të mirë të fëmijës.

Megjithatë, disa dilema vazhdojnë të ekzistojnë.

E para, korniza ligjore për të drejtat e njeriut të fëmijëve, si pjesë e qeverisjes së përgjithshme të së drejtës së njeriut ekziston, duke ofruar për të drejtat gjithëpërfshirëse një lidhshmëri përgjegjëse mbi shtetin – përderisa deri më tani sigurisë njerëzore i mungon kjo normativë. E dyta, siguria njerëzore/siguria e fëmijës i qaset nganjëherë prirjes për (mbi) proteksionizmin, duke theksuar cenueshmërinë dhe varësinë e fëmijës – përderisa mospërfill mundësitë dhe shkathtësitë e fëmijës. Prandaj, sfidat konceptuese për sigurinë e fëmijës mbeten se si më së miri të harmonizojmë aspektin e autorizimit/mundësisë, i/e cili/a është thelbësore për debatin e të drejtave të njeriut. Duke u nisur nga kjo, plotësimi i të drejtës së fëmijës dhe qasjet për sigurinë e fëmijës duhet të theksohen si në përmbajtjen e diskutimit të tashëm mbi pjesëmarrjen e fëmijëve në proceset e paqes dhe rindërtimit, pas konflikteve.

Prej fillimit, Rrjeti për Siguri Njerëzore (RrSN) i ka kushtuar vëmendje të posaqme sigurisë së fëmijës, e veçanarisht në raport me konfliktet e armatosura (përfshirë këtu armët e lehta, çështjet e minave fushore). Ky zotim është reflektuar, po ashtu, në prioritetet e kryesimit austriak në vitin 2002/03 të Rrjetit për Siguri Njerëzore: fëmijët e prekur nga konfliktet e armatosura dhe arsimimin për të drejtat e njeriut.

2. DEFINIMI DHE PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES

Natyra dhe përmbajtja e të drejtave të njeriut të fëmijëve

Koncepti i të drejtave të fëmijëve ka evoluar nga njëra anë nga lëvizja e gjerë për të drejtat e njeriut, por poashtu ka rrjedhur nga zhvillimet e tjera në fushën sociale, arsimore dhe psikologjike në 300 vitet e fundit. Këtu përfshihen edhe ndikimi i përkrahjes institucionale shtetërore për arsim të obliguar në shkollë, efektet negative të industrializimit në fëmijë (për shembull shpërdorimi i fëmijëve në fabrika apo miniera) dhe

>> Çdo shoqëri që dëshiron t'i mohojë fëmijët, apo çdo grup, të drejtat e të cilëve janë pronë e përbashkët e grupeve të tjera, duhet të ofrojë arsye të qarta dhe të qëndrueshme për ta bërë këtë. Ngarkesa e provave gjithmonë mbetet tek ata të cilët dëshirojnë t'i përjashtojnë tjerët nga pjesëmarrja; fëmijët nuk duhet të detyrohen të argumentojnë rastin e tyre për posedimin e të drejtave të njëjta si çdokush tjetër. <<
BOB FRANKLIN (1995)

pasojat e luftës. Një kuptim i ri mbi zhvillimin e fëmijës ka evoluuar, nga koncepti i ri i mësimin dhe modelet e ngritjes së fëmijës në “lëvizje liberale fëmijërore” në vitet e ‘70. Ata ndihmuan që ta zhvendosnin cenueshmërinë e fëmijës dhe nevojat e mbrojtjes në një diskutim të ri mbi autonominë e fëmijës, kompetencën, vetëvendosje dhe pjesëmarrjen e fëmijës, duke i refuzuar botëkuptimet atërore të fëmijëve si objekte të kontrollit prindor/madhor. Përfundimisht, të gjitha këto zhvillime së bashku kanë pasur një ndikim të madh në proceset politike, të cilat filluan brendapërbrenda Kombeve të Bashkuara: skicimi i një trupi të ri ligjor detyruar për të drejtat njerëzore të fëmijës – Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Viti i miratimit të saj - 20 Nëntori 1989 – është përvjetori i *Ditës Ndërkombëtare të të Dejtave të Fëmijës*.

KONCEPTET PARËSORE TË KONVENTËS MBI TË DREJTAT E FËMIJËVE

Fuqizimi i fëmijës, aspektet gjinore dhe të brezave

Duke u bazuar në respektin për dinjtet të të gjitha qenieve njerëzore, KDF e njeh çdo fëmijë si bartës të të drejtave të tij njerëzore: këto të drejta nuk rrjedhin apo ndërvaren nga të drejtat e njeriut apo ndonjë të rrituri tjetër. Kjo është mbështetja për konceptin e autorizimit të fëmijës, duke i mundësuar fëmijës si një subjekt i respektuar dhe qytetar i shoqërisë, që të sfidojë dhe të ndërrojë kufizimet e perceptimeve diskriminuese dhe pritjet nga të rinjtë. Faktikisht, fëmijët mbeten të varur nga të rriturit (falë zhvillimi të

tyre fizik dhe psikik, mungesa e të mirave materiale/të ardhurave dhe ndryshimeve në situatat ekonomike dhe sociale të prindërve si papunësia, shkurorëzimi i prindërve etj.), të që kanë ndikim të mënjëhershëm në standardin e jetesës të fëmijës.

>>njëqind fëmijë, njëqind individë, ne jemi njerëz – jo njerëz që duhet të bëhemi, jo njerëz të së nesërme, por njerëz tani menjëherë – sot <<

JANUZZ KORCZAK, “ SI TË DUHET FËMIJA” (1919)

Garantimi i të drejtave të njeriut për fëmijët, si rrjedhim, nuk krijon një grup shoqëror të “privilegjuar”. Përkundrazi, është një parakusht për ngritjen e statusit të tyre në shoqëri në një shkallë që të mund të mbrojnë interesin e tyre në hapa të njëjtë me të rriturit. Vetëm atëherë fëmija mund të dëshmojë para gjyqit për rastet e kujdestarisë, ku vajza duhet të ndihet e sigurt për raportimin e shpërdorimit seksual. Kjo, po ashtu, nxjerr në pah preventivën e aspektit të ngritjes së vetëdijësimit të autorizimit të fëmijëve. Vetëm atëherë duhet që intereset e fëmijëve si një grup social të merren seriozisht – një sfidë vendimtare, duke marrë parasysh situatën demografike të “shoqërive të moshuara “ në Përendim, por, po ashtu, edhe në hemisferën jugore, ku të rinjtë përbëjnë një numër deri 50% të të gjithë popullatës. Veç këtij aspekti të brezave, dimensionin gjinor është me rëndësi primare për autorizimin e fëmijëve. Trafikimi i vajzave për përdorim seksual, vrasja e vajzave në emër të “nderit familjar”, përjashtimet dhe pengesat në arsim dhe në punë, si dhe stereotipet degraduese në media dhe në industrinë zbatimëse, qartë tregojnë diskriminimin e dyfishtë për to, si vajza dhe si fëmijë.

Pamja e tërësishme e fëmijës

KDF si unik është traktati i parë universal për të drejtat e njeriut që kombinon të drejtat ekonomike, sociale, kulturore, si dhe ato civile dhe politike në një dokument të vetëm. KDF ndjek një qasje gjithëpërfshirëse për adresimin e situatës për fëmijë; ai shkon përtej deklaratave më të hershme për fëmijë, të cilat ishin fokusuar në nevojat e mbrojtjes gjatë zhvillimit të fëmijës, si dhe përfshin kushtet e garantimit të respektit për identitetin e fëmijës, vetëvendosjes dhe pjesëmarrjes.

Marrëdhënia – fëmijë- prind- shtet

Në të njëjtën kohë është me rëndësi të theksojmë se këto dimensione të dyfishta – të drejtat e mbrojtjes dhe të autonomisë – nuk janë reciprokisht të veçanta, por reciprokisht përforcuese: Konventa nuk favorizon p.sh. të drejtën e autonomisë apo atë të mbrojtjes, siç është pretenduar nga kritikët, duke e quajtur KDF-në “anti-familjare” dhe frikë të shpërndarjes së familjes, duke garantuar të drejtat njerëzore për fëmijë. KDF njikuptimisht njeh “përgjegjësitë, të drejtat dhe detyrimet” e të (dy!) prindërve për ofrimin e “drejtimit të duhur dhe udhëheqjen” për fëmijën. Megjithatë, kjo përgjegjësi prindore është kualifikuar duke qenë “e pajtueshme me evoluimin e aftësive të fëmijës”, duke nënkuptuar se kjo përgjegjësi nuk garanton asnjë fuqi absolute mbi fëmijën, por është vazhdimisht dinamike dhe relative. Gjthashtu, përballë shtetit, prindërit bartin përgjegjësinë primare të arsimimit, por në qoftë se nuk janë të aftë apo nuk kanë dëshirë që t’i përmbushin obligimet e tyre, është legjitime për shtetin / shoqërinë që të ndërhyjë.

Mosdiskriminimi i fëmijëve

Konventa shpall qartë ndalesën e diskriminimit të fëmijëve, duke ofruar një listë të gjatë me bazat që nuk pranojnë dallime (po ashtu lidhur me prindin/rojen e fëmijës) si “raca, ngjyra, seksi, gjuha, religjioni, mendimi politik, nacional, origjina sociale apo etnike, prona, paaftësia, lindja apo pozita tjetër” (Neni 2).

>> *Kam ëndërruar se katër fëmijët e mi të vegjël një ditë do të jetojnë në komb ku nuk do të gjykohen për nga ngjyra e lëkurës së tyre, por nga përmbajtja e karakterit të tyre.*<<
MARTIN LUTER KING JR.

Nuk ka kusht të caktuar për mosdiskriminimin e fëmijëve në raport me të rriturit (diskriminim në bazë të moshës). Megjithatë, duke marrë parasysh katalogun e gjerë të të drejtave në KDF, çdo masë kufizuese për këto garanci, e cila bazohet në moshë, do të jetë e vështirë të mbështetet në bazë të Nenit 1 dhe 3(1).

Interesi më i mirë i fëmijës

>>Ardhmëria e çdo pupulli mund të matet drejtpërdrejt nga gjendja prezente e rinisë së tij.<<

XHON F. KENEDI

Neni 3(1) formulon ligjin udhëzues për të gjithë Konventën, i emëruar “*interesi më i mirë i fëmijës.*” Ky nen thekson nevojën për t’i kushtuar vëmendje prioritare interesit të fëmijës. Ai nuk është i kufizuar me veprimet që merren në mënyrë të drejtpërdrejtë me fëmijën (p.sh. arsimimi, gjyqet për rastet e kujdestarisë, etj), por në vend të kësaj, është përshtatur për të gjitha veprimet, të cilat në mënyrë direkte apo indirekte mund të kenë ndikim në fëmijën (politikat punësuese, shpërndarja e buxhetit etj.). Prandaj, kjo le të kuptohet si një obligim nga secili faktor (shtetëror apo privat) për të udhëhequr “vlerësimin e efekteve të fëmija” së pari, t’i parashohë pasojat e mundshme të çfarëdo mase dhe alternative dhe që më tutje të monitorojë zbatimin e asaj mase. Veç kësaj, parimi i “interesit më të mirë të fëmijës” shërben si një masë mbrojtëse për udhëheqjen e çfarëdo shtete, e cila kundërshton të drejtat e KDF-së apo ku asnjë ligj i KDF-së nuk mund të zbatohet.

Definimi i “fëmijës” nga KDF-ja

Së fundi, mbetet pyetja: kush është konsideruar “fëmijë” në Konventën për të Drejtat e Fëmijës? Pra, KDF-ja e definon “fëmijën” në mënyrë të përgjithshme si çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeçare (pos nëse është arritur shumica në shtetin përkatës për ta ndryshuar këtë, Neni 1). Këtu e tutje zgjedhim qasje më të thjeshtë, duke i ndarë të rriturit nga adoleshentët. Nuk ka ndonjë përmendje të kufizimeve të moshës në Konventë (përveç Nenit 38) dhe Komiteti për të Drejtat e Fëmijës – trup ndërkombëtar për mbikëqyrjen e zbatimit të Konventës- vazhdimisht ka theksuar se qasja e KDF-së po ashtu urdhëron shtetet që t’i rishikojnë ligjet e tyre nacionale për përkufizimet e moshës në përputhje dhe justifikim të vazhdueshëm.

Ndarë nga definimi i Nenit 1, ka disa kurthe për zbatimin e KDF-së, sepse grupi “nën moshën 18 vjeç” përbën një grup të llojllojshëm, llojllojshmëri johomogjene sociale, e cila e bën të nevojshëm për të qenë i qartë për grupin e synuar apo masat.

Të Drejtat e Konventës : pjesëmarrja – mbrojtja - dispozitat

Struktura e përdorur më së shpeshti për përshkrimin e Konventës ndarë nga parimet udhëheqëse dhe konceptet e pashtëshënuara vijon më të tri “P-të” Pjesëmarrja – Mbrojtja (Proteksionizmi) – Provizionet (Dispozitat) (PPP)

- Koncepti i pjesëmarrjes është përfaqësuar së pari nga një njohje e qartë e të drejtës së fëmijës për pjesëmarrje, siç është caktuar me Nenin 12(1). Ngarkimi i “peshës së detyrimit” për ardhmërinë e fëmijës është një element kyç në këtë ligj; kërkohet një shkallë e pjesëmarrjes së fëmijëve që i lejon ata që më të vërtetë të ndikojnë në procese dhe të kenë ndikim në vendimmarrje. Në parim, KDF-ja përshtat të drejtat e tjera civile dhe politike të lidhura në këtë përmbajtje si të drejta të fëmijës, siç është liria e vetëdijes, religjionit, shoqërimit, mbledhjes dhe respektit të intimitetit të tij dhe po ashtu të drejtën për jetë (përfshirë ndalesën e qartë të dënimit me vdekje për kundërvajtësit e rinj), mbrojtjen nga tortura dhe nga arresti arbitrar dhe garantimin e gjyqimit të drejtë.
- Sa u përket çështjeve të mbrojtjes (proteksionizmit), e drejta në KDF përmban mbrojtjen për “çfarëdo forme të dhunës fizike dhe mentale, lëndim apo shpërdorim, trajtim mospërfillës apo të shkujdesur, keqtrajtim apo shfrytëzim, përfshirë abuzimin seksual, përderisa është në përkujdesje të prindit apo prindërve, kujdestarit apo kujdestarëve legalë, apo çfarëdo personi tjetër, i cili e ka për detyrë përkujdesjen ndaj fëmijës.” (Ky ligj është po ashtu është i aplikueshëm për masat disiplinuese në shkollë). Mbrojtja është përforcuar më tutje me nenet të cilat ndalojnë shfrytëzimin ekonomik (fuqinë punëtore të fëmijëve), shfrytëzimin seksual dhe trafikimin e fëmijëve, përdorimin e drogës dhe standardet në lidhje me fëmijët dhe konfliktet e armatosura.

>> Në qoftë se dëshirojmë të krijojmë një paqe të qëndrueshme, duhet të fillojmë nga fëmijët.<<

MAHATMA GANDI

- Dispozitat legale të garantuara nën KDF përfshijnë të drejtën për shëndetësi, edukim, sigurim social dhe një standard të mjaftueshëm për jetesë.

Veç kësaj, KDF, po ashtu, zhvillon *standarde të reja*, duke formuluar të drejtën e fëmijës për mbrojtje të identitetit, marrëdhënieve familjare apo sociale e të tjera (përfshirë këtu ribashkimin familjar), ndalesat për adoptime ndërkombëtare të fëmijëve, e drejta e fëmijës për pushim, kohë të lirë, lojë dhe aktivitete kulturore dhe obligim shtetëror për të siguruar shërimin dhe rehabilitimin për të gjithë fëmijët viktime të çfarëdo forme të dhunës apo shfrytëzimit.

Përmbledhje: Pse përdorimi i të drejtës për fëmijë – qasje e bazuar?

- Të drejtat e fëmijëve janë të drejta njerëzore- respekt për dinjitetin njerëzor pa marrë parasysh moshën,
- Të drejtat e fëmijëve e zhvendosin fokusin e vëmendjes- për çdo fëmijë individual dhe për fëmijët si grup shoqëror.
- Të drejtat e fëmijëve janë gjithëpërfshirëse dhe të ndërlidhura – nuk ka shprehje të lira pa ndalim të dhunës, nuk ka të drejtë për arsimim pa një standard të mjaftueshëm për jetesë.
- Të drejtat e fëmijëve janë të drejta juridike – duke përfshirë obligimet shtetërore përkatëse për mbrojtje të tyre dhe realizim.
- Të drejtat e fëmijëve autorizojnë fëmijën – ato kërkojnë një kulturë të re të ndërveprimit me fëmijë, duke u bazuar në njohjen e tyre si subjekt dhe bartës i të drejtave.

3. PRESPEKTIVAT NDËRKULTURORE DHE ÇËSHTJET KONTRAVERSE

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve reflektohet në statusin e fëmijës në shoqëri, në konceptet mbizotëruese për fëmijërinë, shembujt e mveshjeve për fëmijë, kushteve të jetesës dhe infrastrukturës të ndërlidhur me ta. Gjithashtu, shfaq një çështje të madhe sa i përket statusit të familjes dhe po ashtu statusit të femrës në atë shoqëri.

Një shembull tipik i këndvështrimeve kundërshtuese ndërlidhet me ndëshkimin trupor të fëmijëve. Përderisa çdo kod penal në të gjithë botën përshkruan se goditja me qëllim lëndimi është një akt kriminal në mes të të rriturve, parmi i njëjtë nuk është i aplikuar te fëmijët. Në vend të kësaj mund të gjeni diskutime në një numër të “arsyeshëm” të goditjeve me kamxhik, regullore mbi madhësinë dhe materialin e shufrës, apo kërkesën e pranisë së mjekut gjatë ndëshkimit. Është shokuese të shohësh se deri më tani janë vetëm dhjetë shtete në botë, të cilat plotësisht e kanë hequr dënimin trupor. Komisioni mbi të Drejtat e Fëmijës është fokusuar në dhunën mbi fëmijë nga shteti, në familje dhe shkollë gjatë dy diskutimeve tematike më 2000 dhe 2001. Sipas rekomandimeve të tyre, një studim i madh i KB mbi dhunën ndaj fëmijëve u fillua në vitin 2002 në mënyrë që të tërheqë vëmendjen politike botërore për këtë problem.

Edhe një çështje brengosëse e diskutueshme, për shembull, statusi i vajzave (p.sh. “parapëlqimi i djalit” në familje, arsimim, punësim, interpretimet restriktive të ligjeve religjioze, praktikat tradicionale si prerja e gjenitaleve të femrës, qasje në shërbimet e shëndetsisë gjinekologjike), => Moduli për të Drejtat e Femrave apo problemi i fuqisë punëtore të fëmijëve, të cilët janë të lidhur me faktorë dhe kushte të ndryshme në shtetet përkatëse, duke përfshirë strukturën ekonomike, shkallën e papunësisë, varfërinë, kualitetin e sistemit arsimor, statusin e familjeve dhe femrave. => Moduli i punës.

>> A mund të ketë një detyrë më të frikshme sesa obligimi ynë për të mbrojtur të drejtën e fëmijës me një vigjilencë të njëjtë siç i mbrojmë të drejtat e çdo personi tjetër? A mund të ketë një test më të madh për udhëheqje sesa kërkesa për sigurimin e këtyre të drejtave për çdo fëmijë, në çdo shtet, pa përjashtime?<<

KOFI ANNAN, SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KOMBEVE TË BASHKUARA

4. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Zakonisht, në fushën e të drejtave të njeriut, një zbrastësirë ekziston në mes të parimeve dhe praktikës, në mes zotimeve dhe zbatimit aktual, por mund të debatohet se kjo zbrastëritë nuk është askund më e madhe se në të drejtat e fëmijëve. Arsye të ndryshme

mund të jepen për këtë situatë (çështjet e të drejtave të fëmijëve janë të ndërlidhura në diskutimet kontraverse për “vlerat familjare” / kulturore/ traditat religjioze, mungesës së infrastrukturës për fokusim të fëmijëve, mbështetjes për autorizim të fëmijëve apo iniciativë politike), por një faktor më kontribues mund të gjendet në sistemin e dobët monitorues të KDF-së.

>>zbatimi i Konventës nuk është çështje e zgjedhjes, mirëqenies apo bamirësisë, por e përmbushjes së detyrimeve juridike.<<

KOMITETI DREJTUES I TË DREJTAVE TË FËMIJËVE

(PLATFORMA NDËRKOMBËTARE E OJQ-VE PER MONITORIMIN SI VAZHDIM I SESIONIT SPECIAL MBI FËMIJËT), 2002

Konventa ofron vetëm një mekanizëm për mbikëqyrje në pajtim me kushtet e saj, domethënë **raportimin e shteteve** përballë trupit mbikëqyrës, **Komiteti mbi të Drejtat e Fëmijës**. Nën këtë procedurë, shtetet janë të obliguara t’i dorëzojnë raportet në Komision mbi programet e tyre për zbatim të Konventës (protokolet fakultative). Komisioni, si pjesë e “dialogut dobiprurës” me qeverinë përkatëse, duke ua treguar deklaratat kritike dhe rekomandimet, i rishqyrton këto raporte.

Nuk ka asnjë mekanizëm tjetër mbikëqyrës, sikurse edhe me traktatet e tjera të të drejtave të njeriut (ankesa individuale apo shtetërore, apo procedurë hetuese), përderisa lobimi nga OJQ tashmë ka filluar për mekanizmin e ankesave individuale, e cila do ta lejojë Komitetin që ta zhvillojë punën e vet juridike, që është një shtytje e fuqishme për më shumë ligjërim në elaborim juridik mbi të drejtat e fëmijëve.

Mirëpo, Komiteti ka qenë mjaft inovativ për kompensimin e mungesës së mekanizmave tradicionale. Së pari, ai ka marrë një pozicion mjaft të hapur përballë pjesëmarrjes së OJQ-ve , duke i thirrur ato që t’i dorëzojnë raportet e tyre mbi të drejtat e fëmijëve të vendeve të tyre, për të pasur një pasqyrë më të qartë për çështjet kryesore. Së dyti, Komiteti ka nisur forume vjetore (“ Ditët e diskutimit gjeneral”) për tema specifike (p.sh.

“fëmija dhe familja”, “drejtësia për të rinj”, “HIV/AIDS”) në mënyrë që ta përqendrojë vëmendjen ndërkombëtare në këto çështje.

Gjithnjë e më shumë, megjithatë, numri në rritje i standardeve, instrumenteve dhe institucioneve ka sfida të reja për monitorim, dhe kërkon koordinim më të afërt në mes të të gjithë akterëve të përfshirë.

Në shkallë nacionale, procesi pas Sesioneve Speciale mbi Fëmijët të KB 2002 përmban një fakt të rëndësishëm për zbatim dhe monitorim. Dokumenti i lëshuar i thërret të gjitha shtetet për t'i dorëzuar Planet Nacionale për Veprim si bazë e politikave dhe masave të fokusuar për fëmijët, jo më vonë se deri në fund të vitit 2003, “nëse është e mundur”.

>> Nëpërmjet kësaj zotohemi se nuk do të kursejmë asnjë orvatje në vazhdimin të krijimit të një bote të përshtatshme për fëmijët, të ndërtuar në arritjet e dekadës së kaluar dhe të udhëhequr nga parimet e grishjes së parë për fëmijët.<<

“NJË BOTË E PËRSHTATSHME PËR FËMIJËT”, DEKLARIMI DHE PLANI PËR VEPRIM, I MIRATUAR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E KB SESIONIT SPECIAL MBI FËMIJËT, 10 MAJ 2002.

Ky dokument i dalë nga ky **samit** po ashtu përmban angazhimin nga shtetet që ta themelojnë dhe forcojnë mbështetjen dhe monitorimin kombëtar të fokusuar në fëmijë, siç është, një ombdusperson për fëmijë. Ombduspersonët mund të ofrojnë mekanizma të ankesave dhe korrigjimeve, këshillime për fëmijët dhe prindërit, informim dhe lobim si dhe funksione mbikëqyrëse – në përgjithësi duke vepruar si një lobi i institucionalizuar dhe i pavarur. Në parim, mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është ende një fushatë e udhëhequr nga të moshuarit, pra duhet të gjednen forma të reja për përkrahje të fëmijës dhe të hulumtohen iniciativa të të rinjve. Për më tepër, në shumë shtete ka filluar lobimi për përfshirjen e parimeve të KDF në kushtetutat shtetërore, në mënyrë që të ofrojë një kornizë më të fuqishme ligjore për të drejtat e **fëmijëve**. Në këto shtete, si Franca dhe Belgjika, ligjet e KDF-së janë zbatuar direkt në rastet gjyqësore.

Së fundi, orvatje promovuese duhet të bazohet në informata efektive dhe të besueshme, strategji të arsimit dhe kualifikimit (trajnitimit), me mësimet për të drejtat e fëmijës dhe të njeriut të cilat i arrijnë në mënyrë direkte fëmijët dhe të rinjtë. Siç ka deklaruar Komiteti i KDF në vitin 2001 në *Komentin e parë të përgjithshëm mbi "Qëllimet e Arsimimit"* (Neni 29): "Një mësim me përmbajtjen e tij qëndron i rrënjësor në vlerat e Nenet 29(1) që është për çdo fëmijë një vegël e domosdoshme për orvatjet e saj apo atij për të arritur drejtimin e një përgjigjeje jetësore miqësore të të drejtave të njeriut përballë sfidave të cilat përcjellin periudhën e ndryshimeve fundamentale të udhëhequra nga globalizimi, teknologjitë e reja dhe fenomene të tjera të ndërlidhura."

E DOBISHME TË DIHET

1. PRAKTIKA TË MIRA

Shembujt në vazhdim për iniciativë dhe projekte kanë forcuar me sukses zbatimin e Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës, => Referencat dhe informatat shtesë

"Ndërlidhni njerëzit" – një projekt i sponsoruar për refugjatë të rinj në Austri, i organizuar nga Asylkoordination Osterreich (OJQ Austriake për koordinim për refugjatë dhe organizata për migrim), në mbështetje nga Komiteti Austriak për UNICEF.

Ideja themelore e këtij projekti ishte të silleshin së bashku refugjatët e rinj të pashoqërueshëm me të rriturit që jetonin në Austri të cilët kanë dëshirë që të ndajnë diçka me ta, ofrojnë mbështetje praktike për refugjatë, si në arsim, kurse gjuhësh, punë, paraqitje përpara autoriteteve, aktivitete sportive etj. Një lidhje besimi në mes të fëmijës dhe sponsorit është themeluar, duke ndihmuar refugjatin që të stabilizohet në ambientin e tij/saj dhe pasurimi i sponsorit me një përvojë personale. Të gjithë sponsorët janë zgjedhur me kujdes dhe shkojnë në një trajnim paraprak në çështjet juridike, çështjet psiko-sociale, punën me autoritete etj. Prej fillimit të saj në vitin 2000, grupe të reja të sponsorëve janë themeluar çdo vit, duke marrë vlerësime pozitive nga pjesëmarrësit dhe nga publiku, autoritetet dhe mediat.

“ **Recht hat jede/r** – Trainings zum alltäglichen Umgang miteinander” [Çdonjëri ka të drejtë-Trajnim për përditshmërinë tonë] – seri të mbledhjeve të punës të organizuara (workshope) nga WUK Kinderkultur (një nismë e hapësirës kulturore për aktivitetet e fëmijëve) dhe Qendra Shërbyese për Arsim për të Drejtat e Njeriut në Institutin Boltzmann për të Drejtat e Njeriut. Këto seri të mbledhjeve të punës së organizuar synojnë fëmijët (nga 7 deri 15) nga të dy grupet shkollore dhe fëmij/rini, duke u fokusuar në zgjidhjet paqësore të konflikteve, tolerancë dhe komunikim nëpërmjet diskutimit, aktrim, aktivitete grupore; çdo uorkshop zgjat pre 2 ½ orë dhe ndihmohet nga ekipi i dy ekspertëve (ndërmjetësues të trajnuar, motivues argëtimit, psikologë, aktorë, mësues, etj). Prej vitit 2001 modulet mbi “Përgjegjësinë” “Zgjidhjen e konflikteve” dhe “Respektit” janë zhvilluar dhe janë prezantuar në më shumë se 80 workshope, duke i përfshirë më shumë se 1600 fëmijë.

“**Raportet hije**“ **joqeveritare** dhe “**Koalicionet Nacionale**” në zbatimin vendor të KDF.

Palëve shtetërore të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës u kërkohet që të dorëzojnë raportet e përparimit në zbatimin e kësaj konvente rregullisht pranë Komitetit për të Drejtat e Fëmijës të KB. Në mënyrë që të ndihmohet një rishikim gjithëpërfshirës i raporteve shtetërore, Komiteti i mirëpret “raportet hije” të përgatitura nga OJQ apo rrjetet e OJQ-ve (“koalicione nacionale”) në vlerësimin e tyre për gjendjen e fëmijëve dhe adoleshentëve në shtetin nën rishikim. Në më shumë se 90 vende janë themeluar koalicione nacionale për të drejtat e fëmijës, duke promovuar dhe monitoruar zbatimin e KDF. Veç kësaj, një grup i OJQ-ve ndërkombëtare për KDF-në ofron mbështetje për OJQ-të dhe koalicionet në procesin e raportimit dhe monitorimit.

- Pjesëmarrja e Fëmijëve/Rinisë në Sesionin Special të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara mbi Fëmijët, Maj 2002

Aspekti më i shquar i *Samitit të dytë të KB mbi Fëmijët* në New York ishte pjesëmarrja direkte e diku rreth 600 fëmijëve dhe të rinjve (pothuajse 10% e 7000 pjesëmarrësve) nga më shumë se 150 vende në ngjare. Nga 5 deri më 7 maj u mbajt një forum i ndarë i

fëmijëve; porosia e lëshuar pastaj u prezantua në Sesionin Special të Asamblesë së Përgjithshme 98-10 maj) nga një përfaqësues të të rinjve (madje me kërkesë për një rezolutë speciale të AP për t'ua dhënë atyre fjalën). Pavarësisht nga ndalesat e qarta për ndikim të “nën 18 vjeçarëve” në negociata politike brenda KB-së, këto orvatje (përfshirë këtu “versionin e fëmijës miqësor” të dokumenteve të mëdha) reflektojnë shpirtin e KDF për të drejtën e pjesëmarrjes dhe strukturimit të standardeve në proceset e ardhshme të KB.

2. TRENDET

Korniza e KDF-së për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës nuk është një dokument “statik”, por një dokument në zhvillim. Ky proces po forcohet, për shembull. Nga Komiteti për të Drejtat e Fëmijës nëpërmjet interpretimit të KDF apo miratimit të standardeve të reja siç janë *Protokolet Fakultative (2000)* të KDF mbi përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura dhe shitja e fëmijëve, prostitucioni i fëmijëve dhe pornografia e fëmijëve (të dyja hynë në fuqi në vitin 2002).

>>Njerëzimi i detyrohet fëmijës me më të mirën që ka për t'i dhuruar<<

DEKLARATA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS, 1959

Disa nga TRENDET e tanishme në fushën e të drejtave të fëmijëve përfshijnë:

- Aspektet strukturore: fëmijë/rini iniciativat e udhëhequra dhe organizatat, themelimi i zyreve të ombudspersonit për fëmijë dhe rini dhe infrastruktura me fokusim për fëmijët dhe monitorimi i të drejtave të fëmijëve.
- Pjesëmarrja e fëmijëve dhe e rinisë: (lokal, nacional, internacional), përfshirë këtu edhe pjesëmarrjen politike/ të drejtën për votë.
- Aspektet e brezit: mosdiskrimini i fëmijëve kundër të rriturve; shpërndarja e të mirave, qasja në burime; përfaqësim i intereseve të fëmijëve dhe rinisë; ndërrime demografike.

- Të drejtat e vajzës fëmijë: (roli shoqëror modeli/media stereotipet/religjioni/biografia kulturore, shëndetësia gjinekologjike).
- E drejta për informim: qasje në internet/ mbrojtja e të dhënave; përmbajtja e dhunës në media/TV/lojëra kompjuterike, etj.; pronografia e fëmijëve dhe interneti.
- Dhuna ndaj fëmijëve dhe shfrytëzimi seksual i fëmijëve: ndalimi global i dënimit trupor; mbështetja psikologjike.
- Të drejtat e fëmijëve me të meta: (përfshirë arsimimin, trajnimin profesional).
- Fëmijët dhe ekonomia: rrjedhat e përgjithshme të çështjeve të të drejtave të fëmijës në programe të zvogëlimit të varfërisë; eliminimi i fuqisë punëtore të fëmijëve/ eliminimi i formave më të këqija; efektet e globalizmit ekonomik dhe liberalizmi i shërbimeve publike (shëndetësisë, arsimit- GATS); ndikim në industrinë e argëtimit dhe sporteve, publicitetit, mbulesë mediale mbi kulturën e të rinjve.
- Shërbime sociale bazë, efekti i HIV/AIDS.
- Fëmijët në konfliktet e armatosura, reintegrimi i fëmijëve ushtarë; përgjegjësitë e vepruesve jo shtetëror/ kompanive private; roli i Këshillit të Sigurimit: roli i GJNP-së: trajnime për të drejtat e fëmijëve dhe rregullat për sjellje për personelin paqëruajtës/fushor.

Fakte dhe të dhëna- informata statistikore për të drejtat e fëmijës

- **Regjistrimi i lindjes:** më shumë se 50 milion lindje mbeten të paregjistruara çdo vit (75% prej të cilave në Afrikën nën Saharë).
- **Mortaliteti i fëmijëve nën moshën 5 vjeçare:** afërsisht 11 milion fëmijë për vit vdesin nga shkaqe që mund të ndalohen (“sëmundjet më të mëdha vrasëse”: diarea, infeksionet akute të rrugëve të frymëmarrjes, difteria, tuberkulozi, kolli i keq, lia, tetanus); më shumë se 175 vende nuk kanë më sëmundjen e polios.
- **Vdekshmëria e nënave në lindje:** mesatarja botërore: 400 vdekje për 100.000 lindje: Afrika nën-Saharë: 1100; Azia Jugore: 430; Lindja e Mesme dhe Afrika Veriore: 360; Amerika Latina/Karaibet: 190; Azia Lindore/Paqësori : 140; CEE/CIS/Shtetet baltike: 55; vendet e industrializuara:12.

- **Shtatëzani të adoleshenteve:** 18 milion fëmijë që lindin nën moshën 18 vjeçare çdo vit; 23% e femrave (të martuara apo në bashkësi) përdorin kontraceptivë nën Afrikën nën Saharë.
- **HIV/SIDA:** llogaritet se 13 milion fëmijë e kanë humbur nënën apo të dy prindërit e tyre nga SIDA deri në vitin 200: 95% e këtyre fëmijëve gjenden në Afrikën nën Saharë.
- **Ushqimi:** llogaritet se 150 milion fëmijë janë të ushqyer keq.
- **Vrferia:** 3 miliardë njerëz mbeten gjallë me më pak se 2\$ në ditë, 1.2 miliard (50 % e tyre janë fëmijë!) me më pak se 1\$ në ditë; por 1 në 6 fëmijë jetojnë nën shkallën nacionale të varfërisë në vendet më të pasura botërore.
- **Fuqia punëtoare e fëmijëve:** rreth 250 milion fëmijë në mes të moshës 5 dhe 14 vjeçare punojnë; në shtetet në zhvillim është e llogaritur se 70% punojnë në bujqësi dhe sektoret jozyrtare.
- **Fëmijët e rrugës:** llogaritet se 100 milion fëmijë (nga mosha 4 vjeçare e më lart) jetojnë dhe punojnë në rrugë.
- **Arsimimi:** regjistrimi në shkollat fillore: 82% globalisht, por 100 milion fëmijë mbesin jashtë shkollave, 53% prej të cilëve janë vajza.
- **Shërbimet sociale dhe piroritetet politike:** shtetet në zhvillim, mesatarisht, shpenzojnë më shumë në mbrojtje të armatosur sesa në arsim apo shëndetësi; shtetet e industrializuara shpenzojnë më shumë se 10 herë në mbrojtje sesa në ndihmën ndërkombëtare për zhvillim.
- **Konfliktet e armatosura:** vitet e 90-ta: 2 milion fëmijë kanë vdekur në konfliktet e armatosura, 6 milion të lënduar apo të hendikepuar; 300 000 të kyçur direkt në konflikt si ushtarë fëmijë.
- **Refugjatët fëmijë dhe fëmijët e zhvendosur:** 11 milion fëmijë refugjatë janë në botë.
- **Aftësitë e kufizuara:** mesatarisht 120 deri 150 milion fëmijë jetojnë me aftësi të kufizuara.
- **Dhuna:** rreth 40 milion fëmijë nën moshën 15 vjeçare janë viktime të keqpërdorimit familjar apo mospërfillen deri në atë masë, sa të kërkojnë ndihmë

- mjekësore; 2 milion vajza janë në rrezik të prerjes së organeve gjinitale për çdo vit.
- **Trafikimi i fëmijëve:** në Afrikë dhe Azinë Jug-Lindore 400.000 djem dhe vajza janë të prekur për çdo vit; në botë: deri në 2 milion fëmijë dhe femra trafikohen çdo vit.
 - **Vetëvrasjet:** afërsisht 4 milionë adoleshentë në vit tentojnë të vetëvriten në botë, së paku 100 000 nga ta vdesin.
 - **Ombudspersoni për fëmijë:** u themelua në 40 shtete deri më tani.
 - **Planet Nacionale për Veprim (PNV):** pas Samitit Botëror për Fëmijë të vitit 1990: afërsisht 155 vende kanë përgatitur PNV-të.

BURIMI:

RAPORTI I SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË KOMBEVE TË BASHKUARA, “NE FËMIJËT”, I PËRGATITUR PËR SESIONIN SPECIAL MBI FËMIJËT, SHTATOR 2001.

SHIKO NË

WWW.UNICEF.ORG/SPECIALSESSION

3. KRONOLOGJIA

- 1923/24** Deklarata për të Drejtat e Fëmijëve (Gelantyne Jebb / Lidhja e Kombeve)
- 1959** Deklarata për të Drejtat e Fëmijës e KB
- 1989** Konventa për të Drejtat e Fëmijës e KB (e miratuar: 20 nëntor, 1989; hyri në fuqi: 2 shtator 1990)
- 1990** Komiteti për të Drejtat e Fëmijës i KB cakton Raportuesin Special mbi Trafikimin e Fëmijëve, Prostitucionin dhe Pornografinë e fëmijëve
- 1990** Samiti Botëror për Fëmijët në New York (29-30 shtator); miratimi i Deklaratës Botërore dhe Plani për Veprim për Mbijetesë, Mbrojtje dhe Zhvillim të Fëmijëve
- 1990** Karta Afrikane për të Drejtat dhe Mirëqenien e Fëmijëve u miratua (hyri në fuqi: 29 nëntor 1999)

- 1996** Graça Machel dorëzon raportin e lirshëm studimor “Ndikimi i konfliktit të armatosur mbi fëmijët” në Asamblenë e Përgjithshme të KB
- 1998** Gjashtë OJQ ndërkombëtare bëjnë një koalicion për të ndaluar shfrytëzimin e fëmijëve si ushtarë, në mënyrë që të lobonte për të ndjekur shfrytëzimin e fëmijëve në luftë dhe konflikte të armatosura
- 1999** Rrjeti Ndërkombëtar i Sigurisë zhvillon një grup të shteteve të mençura, me një shprehje të fuqishme për situatën e fëmijëve të prekur nga konfliktet e armatosura
- 1999** Konventa nr. 182 për Format më të Rënda të Punës së Fëmijëve e miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës (hyri në fuqi: 19 nëntor 2000)
- 2000** Miratimi i dy protokoleve fakultative për Konventën: për pjesëmarrjen e fëmijëve në konflikte të armatosura (hyri në fuqi: 12 shkurt 2002) dhe për trafikimin e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve (hyri në fuqi: 18 janar 2002)
- 2002** Komisioni për të Drejtat e Njeriut i KB urdhëron studimin më të madh për dhunën kundrejt fëmijëve
- 2002** Forumi i Fëmijëve (5-7 maj) dhe Sesioni Special i Asamblesë së Përgjithshme për Fëmijët i KB në Nu Jork (8-10 maj); Miratohet Deklarata e re dhe Plani për Veprim (Një botë e përshtatshme për fëmijët)

AKTIVITETE TË ZGJEDHURA

AKTIVITETI 1. TAVOLINA E RRUMBULLAKËT PËR VEPRIM PËR TA ZVOGËLUAR PUNËN E FËMIJËVE

PJESA I: HYRJE

Lloji i aktivitetit: Akti dramatik për punën e fëmijëve

PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR AKTRIMIN

Qëllimet dhe synimet: të rritet kuptimi për interesa dhe motive të ndryshme të përfshira në fuqinë punëtore të fëmijëve dhe pasojat e saj për zhvillimet strategjike dhe alternativat e mundshme; ky akt dramatik është si vazhdim nga diskutimet e mëhershme për çështjet e fuqisë punëtore të fëmijëve për t'i familjarizuar pjesëmarrësit me historikun

Grupi i synuar: të rinjtë, të rriturit

Madhësia e grupit: 15-20 pjesëmarrës

Koha: 1-2 orë (duke u bazuar në gjerësinë e “planit për veprim”)

Përgatitja: përgatitje në klasë/dhomë, kartat me emrat dhe funksionin e pjesëmarrësve; përdorimi i pjesëve të gazetave të tanishme për informimin për historikun dhe llojet e ndryshme të roleve dhe pozicioneve, raportet e UNICEF / ONP (ILO) / OJQ-ve për fuqinë punëtore të fëmijëve. => Informimi shtesë.

>> *Njerëzimi i detyrohet fëmijës me më të mirën që mund ta ofrojë*<<.

DEKLARATA E KOMBEVE TË BASHKUARA E TË DREJTAVE TË FËMIJËS 1959

Materiali: letër, hamerë, e gjëra të tjera për dokumentim

Aftësitë e përfshira: aftësitë për komunikim dhe analizë

PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE MBI AKTIN DRAMATIK

Hyrje në temë: Tregoni se problemi i fuqisë punëtore të fëmijës në shtetin X ka pasur një kritikë në rritje nga organizatat vendore të të drejtave të fëmijës dhe asaj ONP ndërkombëtarisht; qeveria ka vendosur ta mbajë një tryezë të hapur për të diskutuar për masat kundër fuqisë punëtore të fëmijëve; pjesëmarrësit përfaqësojnë akterë të ndryshëm (ekipe mundësisht), kryesisht (nuk është e dhënë të përfshihen) fëmijë që punojnë, fëmijë në shkollë, prindër, mësues, organizata të punësimit, unione të tregtisë, zyrtarë të qeverisë, OJQ për të drejtat e fëmijëve, UNICEF/ONP. Qëllimi i fundit i diskutimit duhet të jetë një strategji për procesit të vazhdueshëm (alternativë: elaborimi i planit për veprim)

Shfaqja e aktit dramatik: zgjidhni pjesëmarrësit e tryezës së hapur, u jepni deri në 20 minuta që t'i zhvillojnë pozitat/strategjitë për diskutim (alternative, u jepni materialin për lexim përpara); përfaqësuesi e UNICEF/ONP apo OJQ-ve mund të aktrojnë si kryetar të takimit, duke i prezantuar pjesëmarrësit dhe “funksionet” e tyre. Diskutimi mund të

fillojë me një përmbledhje të gjendjes momentale të fëmijëve, në përgjithësi “fëmijët që punojnë në fabrikë të rrobave” apo prindërit e brengosur për trajtimin e fëmijëve. Pjesëmarrësit duhet të shfaqin qëndrimin e tyre në diskutimin e mbledhjes. Si rezultat një strategji duhet të elaborohet apo një plan për veprim i zhvilluar ndaras në grupe të studimit.

Vlerësimi, këshilla metodologjike: pyetni pjesëmarrësit për ndjenjat, mendimet dhe reagimet gjatë lojës; mendo në veçaniti për rolin “fëmijët”, që të luhet në diskutim.

PJESA IV: VAZHDIMI

Të drejtat e ndërlydhura / fusha të mëtejshme të kërkimit:

Neni 3 (interesi më i mirë i fëmijës), 6 (mbijetesa dhe zhvillimi), 32 (shfrytëzimi ekonomik), 24 (shëndeti), 26-27 (sigurimi social, standardet e mjaftueshme të jetesës), 28-29 (arsimimi), 31 (koha e lirë dhe loja), të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Konventa e ONP (ILO) mbi Format më të Rënda të Punës të Fëmijës më 1999. Diskuto për punën e ONP (iniciativën PNEP - Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve). Shiko për fëmijët që punojnë, në vend që të shkojnë në shkollë në bashkësinë tënde lokale.

2. AKTIVITETI II. MOSPËRFILLJA PRINDORE DHE KEQTRAJTIMI

Lloji i aktivitetit: rast për studim mbi të drejtën për mbrojtje nga dhuna/mospërfillja/keqtrajtimi.

PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME PËR RASTIN E STUDIMIT

Qëllimet dhe synimet: të kuptohet marrëdhënia ndërmjet përgjegjësisë shtetërore dhe asaj prindore për të drejtat e fëmijës dhe mbrojtjen.

Grupi i synuar: të rriturit, të rinjtë

Madhësia e grupit: 10-20 pjesëmarrës

Koha: 1-2 orë

Përgatitja: teksti i rastit për studim

Materiali: letër, tekstet për normat e ndërlidhura me të drejtat e njeriut.

Aftësitë e përfshira: aftësitë për analiza

PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE MBI RASTIN PËR STUDIM

Hyrje në rast, identifikimi i çështjeve kryesore:

Tre fëmijë prej moshës tre deri pesë vjeçare, kanë jetuar me prindërit e tyre në periferi të qytetit. Fqinjët filluan të ankohen te policia lokale dhe tek autoritetet e mirëqenies, se prindërit e tyre grinden shpesh, dhe fëmijët janë dukur të lënë pasdore dhe janë parë duke qajtur shpesh. Në muajt në vijim ka pasur edhe më shumë raportime për fëmijët të cilët vjedhin ushqim, shkojnë në shkollë të palarë dhe ka pasur shenja se ata ishin rrahur ose keqtrajtuar. Autoriteti i mirëqenies së fëmijëve organizoi një takim për shqyrtimin e gjendjes dhe zbuloi se kushtet në shtëpi ishin mjaft të këqija (sanitari e keqe, shtretër të thyer, etj), por ofroi një asistencë vetëm për prindërit, pa një veprim të menjëhershëm sa u përket fëmijëve. Megjithatë, fëmijët filluan të shfaqin shenja të shqetësimeve psikologjike dhe logjike, duke u bërë josocialë me të tjerët; prandaj u mbajtën takimet të tjera ndërmjet autoriteteve legale, prindërve, psikologëve dhe punëtorëve socialë. Kjo vazhdoi katër vjet deri kur fëmijët ishin larguar përkohësisht nga shtëpia për të qëndruar me prindër e kujdestarë për disa muaj. Sapo u kthyen, prindërit e fëmijëve u divorcuan dhe nëna u tha autoriteteve se ata duhet të përkujdesen për fëmijët, sepse ajo nuk mund të bashkëpunonte më tutje dhe do t'i rrihte në qoftë se nuk do të largoheshin nga ajo. Më në fund, autoritetet e mirëqenies dhanë urdhër dhe të gjithë fëmijët u morën nga prindër kujdestarë. Një psikologe përshkruajti përvojat e fëmijëve si "për të thënë troq, tmerruese", duke shtuar se ky rast ishte rasti më i rëndë i mospërfilljes dhe shpërdorimit emocional që e kishte parë ndonjëherë në karrierën e saj profesionale. Përfundimisht, me ndihmën e disa avokatëve, fëmijët i paditën autoritetet lokale duke kërkuar kompensim për vuajtjet e tyre traumatike, në bazë të faktit se autoritetet kanë qenë të vetëdijshme për mospërfilljen e vrazhdë të tyre, shpërdorimin dhe keqtrajtimin nga prindërit e tyre dhe që nuk kanë ndërhyrë me kohë që ta ndalojnë këtë. Por gjykata deklaroi se nuk ka asnjë

kompetencë juridike që të vendosë për kompensim për këtë çështje dhe e pezulloi rastin. Fëmijët tash po këqyrin të bëjnë një ankesë në organet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Çka do të këshillohen ata? Cilat të drejta të Konventës për të Drejtat e Fëmijës mund të jenë shkelur? Cilët traktate të të drejtave të njeriut mund të zbatohen për këtë rast? Cilat mekanizma duhet të përdoren për të shqyrtuar ankesën?

Analiza e rastit/të drejtat e ndërlidhura: Të dyja konventat, Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut mund të përdoret për analizë. Nenet në lidhje të KDF-së përfshijnë: Nenin 3 (interesi më i mirë i fëmijës, përgjegjësia e shtetit), Nenet 5.9.18 (përgjegjësitë e prindërve, mbrojtja e mardhënieve familjare), Nenet 19, 37 (mbrojtja nga dhuna dhe nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues), Neni 27 (standardet e mjaftueshme për jetesë). Nenet në lidhje të KEDN përfshijnë: Neni 3 (mbrojtja nga dhuna dhe nga trajtimi jonjerëzor dhe degradues), Neni 8 (mbrojtja e jetës private dhe integritetit personal), Neni 6 (qasje në drejtësi), Neni 13 (kompenzimi i efektshëm); mekanizmi për ankesë individuale ofrohet vetëm nga KEDN.

Syjerime për ndryshim: Rasti mund të përdoret për aktin dramatik: nga të tri grupet: kandidatët – zëdhënësit qeveritarë- gjykatësit – lejo të diskutojnë rastin dhe mundohu që të arrihet zgjidhja.

PJESA IV: VAZHDIMI

Burimet: Rasti për studim i bazuar në Rastin e Z-së dhe të tjerët në V. Britani e Madhe, Aktgjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut i datës 10 Maj 2001, Padia nr. 29392/95; shih po ashtu rastin e tashëm të K.A. kundër Finlandës, Aktgjykimi i datës 14 Janar 2003, Padia nr. 277751/95 (ndarja e fëmijëve nga prindërit e tyre si vazhdimësi e deklaratave për shpërdorim seksual nga prindërit e tyre – dhunim të Neni 8 KEDN për autoritetet dështim për të ndërmarrë hapa efikas për ribashkimin e familjes).

BIBLIOGRAFIA

Kofi Annan / UNICEF 2001. *“Ne Fëmijët”, raporti i Sesionit Special të Asamblesë së Përgjithshme mbi Fëmijët. UNICEF, New York.*

Asylkoordination Austria / Projekti i Ndërlidhjes së Njerëzve: <http://www.asyl.at>

Instituti për të Drejta të Njeriut Boltzman / Qendra për Shërbim për Arsimimin për të Drejtat e Njeriut: <http://www.humanrights.at/>

Koalicioni për Ndalimin e Përdorimit të Fëmijëve si Ushtarë. 2001. *Raporti botëror.* Publikim i koalicionit, Londër.

Mishell Freman. 1997. *Statusi moral i fëmijës: Ese mbi të drejtat e fëmijës.* Publikime të Martinus Nijhoff, Dordrecht/Boston/Londër.

Garça Machel. 2001. *Ndikimi i luftës të fëmijët.* C. Hrust & CO., Londër.

Amartya Sen. 2002. *Edukimi fillor dhe siguria njerëzore.* Deklaratë në Komisionin mbi Sigurinë Uorkshopi i Kalkutës, në dispozicion në: <http://www.humansecurity-chs.org/>

Komsioni mbi të Drejtat e Fëmijës i KB: <http://www.unhchr.ch/html/menu2/6/crc/>

Sesioni Special i Asamblesë së Përgjithshme mbi Fëmijët i KB 2002: <http://www.unicef.org/specialsession>

UNICEF (i përgatitur nga Hodgkin, Rachel dhe Peter Neëell). 2002. *Doracaku për zbatim të Konventës mbi të Drejtat e fëmijës* (verzioni i korigjuar plotësisht), UNICEF, Gjeneva-Njy Jork.

WUK-Werkstätten – dhe Kulturhaus Vienë:

<http://wuk.at/index/id/7/index.htm>

INFORMATATA PLOTËSUESE

Rrjeti Afrikan për Parandalim dhe Mbrojtje Kundër Keqpërdorimit dhe Mospërfilljes së Fëmijës (RrAPKKMF):

<http://www.anppcan.org/>

Filip Alston (ed.). 1994. *Interesat më të mira të fëmijës: Bashkëndimi i kulturës me të Drejtat e Njeriut.* Shtypshkronja Claredon. Oksford.

Amnesty International Children's Action 1999:

<http://amnesty.org/ailib/intcam/children/kids99/kidindex.htm>

Asquith, Stewart dhe Malcolm Hill (edukatorë) 1994. *Drejtësi për fëmijët.* Publikime të Martinus Nijhoff, Dordrecht/Boston/Londër.

Brett, Rachel dhe Margaret McCallin. 1996. *Fëmijët – ushtarët e padukshëm.* Shpëto Fëmijët, Suedi, Stokholm.

Casa Alianza (Guatemalë): <http://www.casa-alianza.org/>

Qendra Evropian për Fëmijë:

<http://eurochild.gla.ac.uk/>

Child-hood.com (fëmijëria.com) (platforma e internetit kundër turizmit seksual):

<http://child-hood.com/>

Shtëpia e fëmijëve:

<http://www.child-abuse.com/childhouse/>

Rrjeti Informativ për të Drejtat e Fëmijës (RrIDF):

<http://www.cring.org/>

Koalicioni i Fëmijëve- Ushtarë: <http://www.child-soldiers.org/>

Rrjeti Hulamtues Ndërkombëtar për Mbikëqyrje fëmijësh:

<http://www.childwatch.uio.no/>

Këshilli i Evropës / Qendra Evropiane e Rinisë. 1995. *Të gjithë ndryshe – të gjithë të barabartë (pako edukative).* Në dispozicion në: http://coe.int/T/E/human_rights/Ecri/3-Educational_resources/

Mbrojtja e Fëmijës:

<http://www.defence-for-children.org/>

Sharon Detrick (ed.) 1992. *Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve KB. Udhërrëfyes drejt "Travaux Preparatoires".* Publikime të Martinus Nijhoff, Dordrecht/Boston/Londër.

Sharon Detrick (ed.) 1999. *Përshkrim për Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës.* Publikuesi Akademik Kluwer, Hagë.

Gabriele Dorsch. 1994. *Die Konvention der Vereinten Nationen Convention uber die Rechte der Kindes [Konventa per të Drejtat e Fëmijës e KB].* Berlin: Dunker & Humblot.

Fund Prostitucionit, Pornografisë dhe Trafikimi të Fëmijës {FPPTF [ECPAT]}:

<http://www.ecpat.net/>

Rrjeti Evropian i Fëmijëve (EURONET)

<http://europeanchildrensnetwork.gla.ac.uk/>

Rrjeti Evropian për Ombudspersonin për Fëmijë (RrEOF):

<http://www.ombudsnet.org/>

Iniciativa Globale për Fundin e të Gjitha Dënimeve Trupore për Fëmijë (IGFGjDFT): <http://www.endcorporalpunishment.org/>

Goodwin-Gill, Guy dhe Ilene Cohn. 1994. *Ushtarët Fëmijë*. Oxford University Press, Oxford.

Susan Fountain. 1993 . *Është vetëm e drejtë!*. UNICEF, New York.

Bob Franklin (ed.). 2001. *Doracaku i ri i të drejtave të fëmijëve: Politikat dhe praktikat krahasuese* (botimi i dytë). Routledge, Londër/New York.

Michael Freeman (ed.). 1996. *Të drejtat e fëmijëve: një prespektivë krahasuese*. Kompania botuese Dartmouth, Aldershot.

Michael Freeman dhe Philip Veerman (ed.). 1992. *Ideologjitë e të drejtave të njeriut*. Publikime të Martinus Njihoff, Dordrecht/Boston/Londër.

Tomas Hammarberg. 1995. *Të drejtat e fëmijëve të hendikepuar: Konventa mbi të Drejtën e Fëmijës e KB. Në: Degner/Koster-dreese (ed.). Të drejtat e njeriut dhe personat e hendikepuar: Ese dhe instrumentet e tashme të të drejtave të njeriut*. Publikime të Martinus Njihoff, Dordrecht/Boston/Londër.

Ruth Finney Hayward. 2000. *Thyerja e qypit të argjiltë: Mësime nga Azia jugore për përfundimin e dhunës kundrejt femrave dhe vajzave*. Katmandu: zyra rajonale e UNICEF-it për Azinë juglindore.

James R. Himes. 1995. *Zbatimi i Konventës mbi të Drejtën e Fëmijës: Mobilizimet e burimeve në shtetet me të ardhura të vogla*. Publikime të Martinus Njihoff, Dordrecht/Boston/Londër.

Divizioni i Mbikëqyrjes së të Drejtave të Fëmijës: <http://hrw.org/children>

Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës të Fëmijës (PDEP):
<http://www.ilo.org/public/english/standards/ipec/>

An-Magritt Angelo Saporiti Jensen. 1992. *A llogarisin fëmijët? Fëmijëria si një Fenomen Social – Një përmbledhje statistikore (Raportet EUROSOCIAL-e nr. 36).* Qendra Evropiane për Politikën e Mirëqenies Sociale dhe Hulimtim, Vjenë.

Jenny Kuper. 1997. *Ligji ndërkombëtar rreth fëmijëve civilë në konfliktet e armatosura.* Shtypshkronja Claredon. Oksford.

Koalicioni Nacional për Shfuqizimin e Dënimit me Vdekje (SHBA):
<http://ncadp.org/>

Grupi i OJQ-ve për KDF:
<http://www.crin.org/NGOGroupforCRC>

Lista-kontrolluese e OJQ-ve për Fëmijët në Konfliktet e Armatosura:
<http://watchlist.org/>

Aleanca për Shpëtimin e Fëmijëve. 1997. Pakot trajnuese të KDF –së. Londër.

Helmut Christian Hainzl Sax. 1999. *Die verfassungsrechtliche Umsetzung der UN-Kinderrechtskonvention in Österreich [Zbatimi Kushtetues i KDF në Austri].* Botimi Österreich, Vienë.

Programi për Fëmijë e Ndarë në Evropë: <http://sce.gla.ac.uk/>

SOS (fshati ndërkombëtar i fëmijëve) SOS Kinderdorf International:
<http://sos-childrensvillages.org/>

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të KB për ndikimin e konflikteve të armatosura mbi fëmijët:

<http://un.org/special-rep/children-armed-conflict>

Terre de Hommes: <http://www.terredeshommes.org/>

UNICEF: Raporti mbi gjendjen e fëmijëve të botës (publikimi vjetor)

Baza Statistike e UNICEF: <http://www.childinfo.org/>

Geraldine Van Bueren. 1995. *Kuptimi i të drejtave të fëmijës.* Ghent: Qendra e të Drejtave të Njeriut.

Lisa Woll. 2000. *Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtën e Fëmijës Studim i Efekteve.* OJQ Shpëto Fëmijët, Suedi, Stokholm.

Grupet Punuese për Vajza: <http://grilsrights.org/>

Organizata Botërore Kundër Torturës (OBKT)

Programi për të Drejtat e Fëmijëve: <http://omct.org/>

World Vision International: <http://www.wvi.org/>

Kongresi Botëror kundër Shfrytëzimi Komercial dhe Seksual të Fëmijëve:

<http://csecworldcongress.org/>